


# POPULLI MERR VENDIMIN MË TË MIRË



# DEMOKRACIA NË KOSOVË, RREZE DIELLI

VLERA (9), SHENDRIT (10), SHUKRIE (10), SEJDI (9), DRENUSHA (10), RINESA B. (10), HALIT (9),


RINESA M. (10)



Në demokracinë përfaqësuese, qytetarët i zgjedhin përfaqësuesit e tyre me anë të votës

## Përfaqësimi i shtetit tonë varet nga ajo se kë e zgjedhim ne qytetarët e Republikës së Kosovës. Kjo ndodh kështu, sepse ne jetojmë në një shtet demokratik

Sot është një ditë shumë e veçantë për ne. Mësueset tona të dashura e përmbushën premtimin që na e dhanë ditë më parë. Ky premtim ka të bëjë me pjesë-



marrjen tonë në Punëtorinë për Demokraci „Demos-ti“. Emërtimi i projektit „Demos-ti“ rrjedh nga bashkimi i fjalës greke „demos“ që do të thotë popull dhe përemrit „ti“, ku na drejtohet të gjithë qytetarëve sepse ecili nga ne është populli. Qëllimi i këtij projekti është që të na vetëdijësojë për rëndësinë e demokracisë dhe rolin tonë të rëndësishëm që e kemi në qeverisje. Demokracia është një thesar i mbushur me shumë gjëra të vlefshme, të cilin po nuk ditëm ta shfrytëzojmë, në fund do të mbesim pa asgjë. Vlerat apo ele-

mentet e demokracisë janë ato të cilat e përmbushin përditshmërinë tonë. Po cilat janë ato elemente? Ato janë: liria, paqja, respekti, solidariteti, barazia, etj. E kur jemi tek barazia, ne po që ndihemi të barabartë në shtetin tonë. Këtë e themi, sepse në kohët e mëparshme qytetarët kanë qenë shumë të diskriminuar për nga gjinia, mosha, feja, etj. Tani kjo gjë nuk ndodh më. Demokracia ka ndryshuar dhe është kompletuar, prandaj njerëzit në demokraci janë të barabartë dhe të lumtur. Përfaqësues në shtetin tonë janë deputetët, sepse në Kosovë kemi demokraci përfaqësuese me sistem parlamentar.

Do të donim të mos pushonte kurrë së lulëzuar kjo formë e qeverisjes, sepse kurrë më shumë se tani nuk kemi pasur më shumë të drejta. Prandaj, ne duhet ta duam dhe ta mbrojmë çdo cep të shtetit tonë, sepse vetëm në këtë mënyrë ne do të shkojmë përpara.




Gazetarë e deputetë në një ditë të vetme



# UNË I PËRFAQËSOJ QYTETARËT E SHTETIT TIM

ERION (10), BLERTON (10), ENVER (10), FATJONA (10), LORESA (10), VLERSINA (10), BLEONA (9),

AGNESA (10)




**Unë jam Kuvendi i Republikës së Kosovës. Kam rol përfaqësues, legjislativ dhe kontrollues. Qëllimi im është t'i mbroj dhe t'i përfaqësojë qytetarët e shtetit tim demokratik**

Të dashur miq, të gjithë mua më njohin si „Shtëpia e Ligjeve“, për arsye se tërë punën e realizoj në shërbim të popullit tim. Unë jam institucion demokratik, sepse zbatoj me përpikëri vlerat demokratike. Këto vlera demokratike që zbatoj janë: liria, barazia, toleranca, respekti, liria, etj. Unë mundohem që secili qytetar të

ligjet që kam miratuar për popullin tim, është ligji i cili thotë se të gjithë qytetarët duhet ta përfundojnë shkollimin fillor dhe atë të mesëm të ulët. Kjo është bërë, sepse kur populli im është i arsimuar i tërë shteti funksionon më mirë. Unë, pra, nxjerr dhe miratoj ligjet dhe ndihem krenar kur populli zbaton këto ligje. Çdo 4 vjet mbahen zgjedhjet për mua, sepse kështu funksionon shteti demokratik. Në këto zgjedhje, votohen kandidatët për deputetë. Ata që janë më të mirët do t'i përfaqësojnë kërkesat dhe interesat e popullit në „Shtëpinë e Ligjeve“.

Unë kam edhe një sallë ku mbahen mbledhjet e deputetëve që janë të njohura si seanca plenare. Këto seanca udhëhiqen nga Kryetari i Kuvendit, i zgjedhur po ashtu nga deputetët. Prandaj, qytetarë të dashur, nëse ju zbatoni ligjet unë kam vullnet që të punoj edhe më shumë. Mos harroni se unë jam në shërbimin tuaj. Së bashku mund ta forcojmë edhe më shumë demokracinë e shtetit tonë.



ndihet i lumtur, i barabartë dhe person me vlerë. Normalisht, se këtë e realizoj duke siguruar shkollim të mirë, shëndetësi të mirë, zhvillim ekonomik, të drejta të barabarta e shumëçka tjetër. Tërë këtë punë e bëj duke punuar me shumë përgjegjësi dhe përkushtim, sepse populli im më ka besuar votën e tij të çmuar. E meqenëse qytetarët më kanë besuar votën, unë punoj për ta dhe siguroj të ardhmen e tyre. Një ndër



Kuvendi na përfaqëson edhe ne fëmijëve

## ZGJEDHJA ËSHTË E JONA

ARDONIS (10), BLEONDIN (9), ELMAZ (10), ALIJE (10), ELTON (10), EDI (10)

Vota ime  
e drejta ime



### Artikull që flet për zgjedhjet


Nuk është e lehtë të zgjedhësh. Kur jemi pranë vendimeve të mëdha, ne duhet të zgjedhim dhe ai vendim shpesh e vendos të ardhmen tonë.

Ne si nxënës shpesh kemi zgjedhur. Mirëpo, edhe në të ardhmen do të zgjedhim. Nganjëherë, në klasë kur kemi kohë të lirë e bëjmë ndonjë aktivitet. Ka raste kur nuk është e lehtë të zgjedhim cilin aktivitet duam ta luajmë. Prandaj, ne votojmë aktivitetin tonë të preferuar. Kështu, jemi të drejtë me njëri-tjetrin.

Njësoj edhe populli në demokraci i zgjedh përfaqësuesit e vet, me anë të votës. Ky proces njihet si procesi zgjedhor dhe mbahet çdo 4 vjet. Në këtë proces, kanë të drejtë të marrin pjesë të gjithë qytetarët, pa dallime. I vetmi kusht është që të jemi mbi moshën 18 vjeçare.

Në Kosovë kemi dy lloje të zgjedhjeve. Janë zgjedhjet qendrore dhe ato komunale. Në zgjedhjet qendrore, i zgjedhim përfaqësuesit tanë të cilët janë deputetët. Kurse, në zgjedhjet komunale, i zgjedhim kryetarët e komunave përkatëse dhe asamblistët e asaj komune. Ne sot në Punëtorinë „Demos-ti“ e kuptuam rëndësinë e votës dhe duam që edhe ju ta kuptoni rëndësinë e saj. Vota juaj është zëri juaj në vendimmarrjen e shtetit. Ngrite zërin tënd përmes votës, sepse ajo është e drejta jote. Ti je ndryshimi.

Një votë e juaja bën që ju të sjellni ndryshim në vendin tonë. Kurrë mos e harroni këtë!



Demokracia të jep mundësinë për të zgjedhur




Qytetarët vendosin vet për të ardhmen e tyre



E ardhmja e vendit, gjatë shkruarjes së artikullit

# AKTIV PËR KOMUNITETIN TONË

RION (10), EDISON (10), BLERTON (11), SEVDIJE (10), AGNESA (10), LORIKA (10), JETON (10)



## Grupi ynë me shumë kënaqësi, në këtë artikull ju flet se si mund të jemi qytetarë aktiv në demokraci

Unë quhem Edison. Bashkë me klasën time kam ardhur në Punëtorinë e Demokracisë „Demos-ti“.

Jam duke shkruar në emër të grupit ku unë bëj pjesë. Grupi ynë quhet „Dredhëza“. Tema që ne kemi diskutuar bashkë me edukatoren tonë ishte „Qytetaria Aktive“. Meqë ne jemi gazetarë sot, patjetër se këto informata do t'i ndajmë edhe me ju.

Atëherë, ju e dini të dashur lexues se ne jetojmë në Kosovë dhe shteti ynë është shtet demokratik. Si i tillë, neve na siguron shumë të drejta. Disa nga to janë: e drejta e shkollimit, e drejta e shprehjes së lirë, e drejta e votës, etj. Ne si qytetarë, gjithashtu kemi edhe përgjegjësi. Disa nga përgjegjësitë tona janë: të paguajmë taksat, të ruajmë objektet publike, të mbrojmë dhe

pastrojmë ambientin, etj. Të gjitha këto përgjegjësi ndikojnë që ne të jemi qytetarë të mirë dhe të përgjegjshëm. Mirëpo, kjo nuk është mënyra e vetme se si ne mund të japim kontributin tonë në shtetin tonë. Këtë mund ta bëjmë duke marrë pjesë në procesin zgjedhor dhe në tubime publike, duke nënshkruar peticione, duke bërë punë vullnetare, etj.

Gjithsesi se edhe ne si nxënës mund të jemi aktiv. Klasa jonë për shembull mund të organizohet, të mbledh ndihma të ndryshme që mund të jenë të holla, rroba apo ushqim dhe këto ndihma t'i dërgoj tek familjet që kanë nevojë. Kështu ne jo vetëm që do t'i lumturonim ata, por do ta lumturonim edhe veten tonë.

Ndjenjë shumë e mirë është të bësh diçka për komunitetin tënd. Këtë ndjenjë mund ta përjetojmë të gjithë. Të marrim iniciativa të ndryshme dhe të ndikojmë për mirë në vendin tonë. Këtë ua themi ne.



Mbajmë pastër shkollën tonë



Autorët aktiv të artikullit





## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:  
Tel: +381 38 704 560  
E-mail: [info@demos-ti.org](mailto:info@demos-ti.org)  
Website: [www.demos-ti.org](http://www.demos-ti.org)

Pjesëmarrësit:  
SHFMU „Halil Alidema“  
Klasa: V-1 & V-2  
Vendi: Pozheran, Viti